



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.48 dt.27.03.1998

**MBI  
SHQYRTIMIN E ANKESAVE PER DHENIE TE LEJES  
SE NDERTIMEVE NGA K.RR.T.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.27.03.1998, pasi shqyrtoi shkresat e ardhura nga Prefektura e Tiranës me Nr.153, 91/1 dt.09.02.1998 si dhe ankesat e qytetarëve të tjerë, duke u mbështetur në ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për Organizimin dhe Funkionimin e Pushtetit Lokal”, si dhe ligjin Nr.8015, dt.19.10.1995 “Për disa ndryshime në ligjin Nr.7693, dt.26.04.1993 për urbanistikën :

**VENDOSI**

1. Kërkesa e Z. Pjetër Cara të ndërtojë një kioskë, duke kundërshtuar vendimin e K.RR.T. Nr.672, e cila e quan të parregullt kërkesën.  
Këshilli Bashkiak e gjen me vend vendimin e K.RR.T.-së.
2. Ankesa e disa qytetarëve kundër lejes së ndërtimit për godinën 7 katëshe në rrugën “Sh.Ishmi” është shqyrtuar një herë dhe leja është gjetur e rregullt.  
Ndërkohë çështja është në trajtim gjygsor.
3. Shkresa e ardhur nga Prefektura e Tiranës si dhe ankesa e qytetarëve për ndërtesën e banimit në rrugën “M.Gjollesha” pranë Mozaikut të Tiranës.

Kushtet urbanistike plotësohen, i sugjerohet Drejtorisë së Urbanistikës të konsultohet me Ins.Mon.Kulturës nëse në këtë truall ka mbeturina të ndërtimeve të lashta me vlerë.

Këshilli Bashkiak e gjen me vend, vendimin e K.RR.T.

4. Ankesa e pronarëve në rrugën “Mihal Duri” për ndërtim pranë pronës së tyre në kundërshtim me lejen e K.RR.T. nuk është kompetenca e Këshillit Bashkiak.
5. Ankesa për ndërtesën që po ngrihet në rrugën “Gjon Buzuku” Nr.2, Këshilli Bashkiak e sheh, me vend vendimin e K.RR.T. dhënë për leje ndërtimi për ndërtesën 4 katëshe.
6. Ankesa për ndërtimin në kryqëzimin e rrugës “Shenasi Dishnica” me “4 Dëshmorët” Këshilli Bashkiak e sheh me vend që Drejtoria e Urbanistikës të kontrollojë piketimin dhe të ndjekë zbatimin e punimeve për tu zbatuar rregullat e sigurimit teknik. Vendimi i K.RR.T. qëndron.
7. Ndërtimi në rrugën “Vaso Pasha” i plotëson kushtet e ndërtimit, por ndërtimi pa leje i shtesës ka reduktuar distancën 12m në 6m, prandaj ankesa është e pajustificuar.
8. Shkresa e ardhur nga Prefektura e Tiranës për lejen e dhënë ndërtim pranë kopshtit Nr.18, është pezulluar, deri sa të rregullohet gjendja për të mos cënuar kopshtin.
9. Shkresa e ardhur nga Prefektura e Tiranës për shtesën anësore në rrugën “H.Hidi” e cila është miratuar nga K.RR.T. duhet të rishqyrtohet në K.RR.T., sepse ka paqartësi.
10. Shkresa e ardhur nga Prefektura e Tiranës si dhe ankesa e Drejtorisë Arsimore e Tiranës lidhur me kthimin e një pjese trualli të oborrit të shkollës dhe nuk është çështje që lidhet drejtpërdrejt me Këshillin Bashkiak, sepse nuk dëmton shkollën “Fan Noli”.
11. Zbatimi i vendimit të bëhet nga Drejtoria e Urbanistikës.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**